



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

Kodi: 015

## **EDUKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËS**

### **TRAJNIMI PËR KËSHILLËTARË PËR TË DREJTAT E FËMIJËS**

#### Objektivat e programit:

Me përvetësëmin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:

- T'i përshkruajnë, t'i shpjegojnë dhe t'i demonstrojnë konceptet themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut dhe të fëmijës;
- Të shpjegojnë, të argumentojnë dhe të demonstrojnë zhvillimin dhe evoluimin historik të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës;
- Të përshkruajnë të drejtat politike, qytetare, shoqërore dhe ekonomike, kulturore dhe ambientale të njeriut dhe të fëmijës;
- T'i identifikojnë rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të fëmijës;
- Të përshkruajnë funksionin, strukturën e organizatave botërore që merren me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës;
- Të përshkruajnë metodologjitë e mësimdhënies dhe të përgatitjes së materialeve për edukimin dhe arsimimin e nxënësve për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës;
- Të numrojnë, përshkruajnë dhe të demonstrojnë dije lidhur me instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës;
- Të përshkruajnë 4 objektivat kryesore të Kombeve të Bashkuara;
- Të aktivizohen si trajnerë, avokatë, fasilitatorë apo vullnetarë në mbrojtjen dhe në fuqizimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës;
- Të organizojnë trajnime, këshillime, ligjërata dhe ekspozë të ndryshme në temën fuqizimi i të drejtave të njeriut dhe të fëmijës nëpërmjet edukimit dhe arsimit;
- Të integrohen në rrjetin e trajnerëve dhe të këshilltarëve për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës.

## Përmbajtja:

**1. Bota e të drejtave të njeriut.**– Pse shoqëria kosovare duhet të të përjetojë një "metanoia"? Ç' kuptojmë me termin i/e drejtë? Themelet dhe bazat pedagogjike të të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut janë standarde pa të cilat nuk mund të jetohet. Të drejtat e njeriut janë parime morale, sepse u takojnë vetëm njerëzve. Të drejtat e njeriut janë parime morale të drejtësisë, barazisë të pranuar gjërësisht nga shoqëria. Koncepti i të drejtave të fëmijës dhe të njeriut. Të drejtat burojnë nga nevojat. Mohimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Vetitë karakteristika e të drejtave të njeriut. Kufizimi i të drejtave të njeriut. Ndërvarshmëria e të drejtave të njeriut. Të drejtat njeriut në konflikt.

**2. Kombet e bashkuara dhe Këshilli i Europës- Mbrojtës të paqes dhe të drejtave të njeriut.**– Roli i Kombeve të Bashkuara në mbrojtjet e të drejtave të njeriut. Objektivat e Kombeve të Bashkuara. Karta e Kombeve të Bashkuara.

**3. Historiku i së drejtës.**– Filozofitë pararendëse. Aktet e para. Të drejta e fëmijës në rrjedhën e tyre historike. Organizma të fuqishëm në mbrojtje të drejtave të fëmijës. UNICEF - Fondacioni i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët.

**4. Edukimi për të drejtat e njeriut dhe fëmijës.**– Koncepti edukimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës- ç' kuptojmë me edukim për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës? Detyrat e shtetit në promovimin dhe në fuqizimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës nëpërmjet edukimit dhe arsimimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës nga këndi i instrumenteve dhe i standardeve ndërkombëtare. Detyrat dhe obligimet e shtetit që dalin nga Rekomandimet dhe Deklaratat e UNESCO-s.. Kush është UNESCO-ja? Detyrimet e shtetit për të promovuar arsimin mbi bazat e rekomandimeve dhe të deklaratave për zhvillimin e obligimit për edukim dhe arsimim për të drejtat e njeriut. Sfidat kryesore në arsim dhe strategjitë për përballjen me to. Rekomandimet për arsimin për Mirëkuptim , Bashkëpunim dhe Paqe. Rekomandimet e kongreseve ndërkombëtare për arsimimin për të drejtat e njeriut

**5. Praktikimi dhe ushtrimi i aktivitetit të edukimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës.**– Si të aktivizoheni për punë në edukimin për të drejtat e njeriut/ fëmijës. Ndërmarrja e aktiviteteve praktike. Përpilimi i planeve për aktivizim për edukim në fushën e të drejtave të njeriut dhe fëmijës. Analiza SWOT. Trungu problemor.

**6. Disa aspekte të veçanta të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.**– Disa aspekte të veçanta të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Demokracia. Globalizimi. Varfëria dhe të drejta e njeriut dhe të fëmijës. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut. Paqja dhe të drejtat e njeriut. Konfliktet dhe zgjidhja e tyre. Të drejtat e gruas. Tregëtia me gra dhe vajza. Të drejtat sociale (e drejta për punë; punësimi, sindikatat, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, siguria e njeriut, e drejta për mbrojtje shëndetësore. SIDA dhe shëndeti, të rinjët dhe shëndeti, sporti).

**7. Edukimi për të drejtat e fëmijës.**– Ç'kuptojmë me edukim për të drejtat e fëmijës. Fëmijët në Botën, Evropën dhe Kosovën e sotme. Disa vendime të Këshillit të Evropës

lidhur me të drejtat e fëmijës (Interneti dhe pornografia, Ombudsmani – zëdhënës i hapur). Nevojat dhe të drejtat e fëmijës. Konventa për të drejtat e fëmijës (Pse u përpilua Konventa për të Drejtat e Fëmijës? Rrënjët e Konventës.Vendi i Konventës në mesin e Konventave të tjera për të drejtat e njeriut. Çka përmban Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Të drejtat e garantuara të fëmijës me Konventën për të drejtat e fëmijës; sfidat kryesore të shteteve në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Disa shembuj të shkeljes së drejtave të fëmijës.).

**8. Metodologjia e edukimit dhe e arsimit për të drejtat e fëmijës.**– Njohja e të drejtave të fëmijës nga fëmijët. Karakteristikat e programit të edukimit për të drejtat e fëmijës. E drejta e fëmijës që t'i dij të drejtat e veta. Modele të njësive mësimore në temën të drejtave të fëmijës. Konventa e shkurtuar e të drejtave të fëmijës.

**9. Edukimi ndërkulturor dhe të drejtat e njeriut.**– Pse e realizojmë edukimin e të drejtave të njeriut në shkollë? Të drejtat dhe përgjegjësitë. Kur mësohen të drejtat e njeriut? Cili është efekti nëse nuk realizohet edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut?

**Dituritë:** Edukimi i të drejtave të njeriut në kurikulin kombëtar. Gjuha amtare dhe gjuha e huaj. Matematika. Historia. Edukim qytetar.Gjeografia. Shkencat e natyrës. Artet, Muzika.

**Aftësitë:** Bashkëpunimi. Vrojtimi. Komunikimi. Koneceptet kyçe. Të menduarit kritik. Kujdesi.Veprimi.

**Vlerat:** Karta e të drejtave të njeriut. Dinjiteti njerëzor. Kurioziteti. Vlerësimi i kulturave të ndryshme.Drejtesia dhe besnikëria. Zgjidhja e konflikteve. Të kuptuarit. Solidariteti.

**Metodologjia:** Barinstorming. “Mikrofoni magjik”. Koha në rreth. Simulimi dhe loja (Loja me role. Simulimi i mbledhjes. Lojërat). Metodot që forcojnë vetvlerësimin (Fotografitë. Pune me tema- e drejta në familje; shkrimi i letrave; shembul i politikës së gjithë shkollës në edukimin e të të drejtave të njeriut. Projekti shkollor në fushën e të drejtave të njeriut).

**10. Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave të njeriut.**– Monitorimi. Qëllimi i monitorimit. Monitorimi, planifikimi dhe zbatimi. Analiza e situatës. Kuptimi për treguesit. Kuptimi i vlerësimit. Monitorimi i të drejtave të fëmijës. Parimet. Pakoja e treguesve për të drejtat e fëmijës (Treguesit për zbatimin e Konventës. Treguesit e buxhetit që mbështet zbatimin e Konventës. Treguesit për liritë civile dhe pjesëmarrje aktive të fëmijëve. Treguesit që lidhen me të drejtën në emër, shtetësi identitet. Treguesit për mbrojtjen nga tortura, mohimi i lirisë dhe keqtrajtimi. Treguesit për mjedisin familjar dhe kujdesin alternativ. Treguesit për kujdesin jashtë shtetësisë. Treguesit për përkrahjen sociale dhe nivelin e jetesës. Treguesit për shëndetin bazë dhe mirëqenien (Fëmijët nën 5 vjeç: Shëndeti mendor; Shërbimet e shëndetit. Fëmijët. Imunizimi. Shëndeti mendor-vetëvrasjet; Shërbimet shëndetësore: mundësia për kujdes. Mundësia për ujë të pishëm dhe higjienë . Ekzistenca në shkollë e programit për higjienë. Fëmijët me nevoja të veçanta. Standardet e jetesës dhe të sigurisë sociale.). Treguesit për

arsimin, kohën e lirë, aktivitetet kulturore. Treguesit për masat mbrojtëse speciale. Treguesit për fëmijët që shfrytëzohen për çështje ekonomike.

Vlerësimi i të drejtave të fëmijës. Programi i vlerësimit. Vetvlerësimi. Instrumentet për vlerësimin e të drejtave të fëmijës: Testet. Listëkontrolli.

**11. Disa përkufizime terminologjike të shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut.**– Anti-semitizmi dhe urrejtja ndaj romëve. Aparteidi. Diskriminimi. Diskriminimi fetar. Gjenocidi. Holokausti. Homofobia dhe diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Homocidi. Ksenofobia. Racizmi. Shkelja e të drejtave të:imigrantëve, refugjatve dhe të azilantëve. Shkelja e të drejtave të invalidëve dhe të hendikepuarve.

**12. Raporti i vlerësimit.**– Titulli. Vendi. Të dhënat për raport.Periudha e mbualar nga raporti. Data e paraqitjes së raportit.

**13. Katalogu i lojërave.**– Mënyrat e prezantimeve. Ndarja e fëmijëve në grupe. Lojëra të koncentririmit. Lojëra të komunikimit. Mënyra të ndryshme argëtuese që zgjojnë imagjinatën.

**14. Deklarat Botërore për Mbijetim, Mbrojtjen dhe Zhvillimin e fëmijëve.**– Sfidat. Mundësitë. Detyrat. Detyrimi. Hapat e ardhshëm.

**15. Plani Aksional për Zbatimin e Deklaratës në Favor të Mbijetesës, Mbrojtjes dhe të Zhvillimit të Fëmijëve.**– Hyrja. Masat e posaçme në favor të mbijetesës, mbrojtjes dhe të zhvillimit të fëmijës. Aktivitetet e përcjelljes dhe të kontrollit.

#### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësimeve, administratorëve, volunteerëve dhe fasilitatorëve për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës , juristëve, policëve, studentëve dhe pedagogëve universitarë.

#### Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi për aftësimin e këshilltarëve për të drejtat e fëmijës organizohet në formën e kursit 5 ditor me gjithsej **30 orë**. Gjatë zhvillimit të trajnimeve për këshilltarë bëhet monitorimi

#### Certifikimi

Certifikimi për këshilltarë bëhet në dy nivele

1. Certifikimi për pjesëmarrje
2. Certifikimi për këshilltarë

Kriteri për certifikim për pjesëmarrje është vijimi i të gjitha seminareve. Certifikim për këshilltarë bëhet në përputhje me kriterët dhe standardet e përcaktuara nga KEC.